

THE GERMAN LANGUAGE IN NORTH MACEDONIA

GJUHA GJERMANE NË MAQEDONINË E VERIUT

Shadan RAMADANI¹

¹* Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: shadan.ramadani@unite.edu.mk

Abstract

This study will give effort to analyse the situation of the teaching situation of the German language in grade schools and high schools. There are very few documents which handle teaching directly, as a second language in schools. The education system in North Macedonia is more focused on subjects like English, Math and the Macedonian language as a main educational language. During the last decade there have been made some broad reforms to improve the quality in the general system of Kindergartens, grade schools, middle schools and high schools, and colleges in North Macedonia. Teaching two foreign languages in grade schools and high schools, in which the German language is establishing itself more and more as the most preferred language, has had a positive influence in the teaching-learning process of the French and the German language. During the last years there have been some renewals of curriculums and educational programmes.

Keywords: *education system, German language, teaching, grade school, high school.*

Përmbledhje

Në këtë studim me anën e një analize do të shtjellohet situata e mësimdhënies së gjuhës gjermane si në shkollat fillore ashtu dhe në ato të mesme. Ka shumë pak dokumente që flasin në mënyrë të drejtpërdrejtë për mësimdhënien e gjuhës gjermane, si një gjuhë e dytë nëpër shkolla. Sistemi arsimor në Maqedoninë e Veriut është më shumë i përqendruar te lëndët e anglishtes, matematikës dhe gjuhës maqedone. Për të përmirësuar cilësinë dhe kualitetin në sistemin e përgjithshëm parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë në Maqedoninë e Veriut dekadën e fundit janë ndërmarrë reforma të gjera.

Mësimi i dy gjuhëve të huaja në shkolla fillore, të mesme dhe gjimnaze, ndër të cilat gjuha gjermane etablohet si gjuhë më e preferuar, ndikoi pozitivisht mësimdhënien/nxënien e gjuhës frënge dhe gjermane. Gjatë viteve të fundit ka pasur një ripërtëritje të kurrikulave dhe programeve të arsimit.

Fjalët kyçe: *sistemi arsimor, gjuha gjermane, mësimdhënia, shkolla fillore, shkolla e mesme.*

1. Hyrje

Në përgjithësi, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sigurimi i të dhënave dhe informacioneve në lidhje me mësimdhënien e gjuhës gjermane është problematik, sepse në të shumtën e rasteve këto të dhëna mungojnë. *Ka shumë pak dokumente që flasin në mënyrë të drejtpërdrejtë për mësimdhënien e gjuhës gjermane, si një gjuhë e dytë nëpër shkolla. Sistemi arsimor në Maqedoninë e Veriut është më shumë i përqendruar te lëndët e anglishtes, matematikës dhe gjuhës maqedonane si gjuha kryesore e arsimit.*¹⁰¹

Shumë studiues, mungesën e këtyre të dhënave, mundohen ta plotësojnë me metoda kërkimore të tjera shtesë, *si intervistat me mësuesit, drejtuesit e shkollave, apo specialistët e tjerë të fushës.*¹⁰² Në këtë drejtim ndihmon dhe një studim i organizuar nga OECD, i cili quhet *TALIS*¹⁰³ dhe studion karakteristikat e mësimdhënies dhe të mësuarit në rang ndërkombëtar, duke anketuar mësuesit dhe drejtuesit e shkollave për kushtet e tyre të punës, mjediset mësimdhënëse në shkollat e tyre në mënyrë që të ndihmojë vendet për përballimin me sfidat. Sistemi arsimor në RMV pasqyron nevojën e shoqërisë për rolin e rëndësishëm, që luan arsimi, shkenca dhe edukimi në zhvillimin ekonomik, social, teknologjik dhe kulturor.¹⁰⁴

2. Mësimi i gjuhëve huaja në Maqedoninë e Veriut

Sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sa i përket arsimit me formim të përgjithshëm, është i detyrueshëm duke filluar nga mosha 6 deri në 19 vjeç. Ndërsa për arsimin profesional dhe të profilizuar është i detyrueshëm nga mosha 6 deri në 17, 18 dhe 19 vjeç.¹⁰⁵ Mësimi i gjuhëve të huaja fillon në klasën e parë, atëherë kur nxënësit janë rreth moshës 6 vjeç. Në shumicën e rasteve, gjuha e parë e huaj që ata mësojnë është gjuha angleze. Në klasën e katërt, të ciklit të ulët, fillon mësimi i gjuhëve lokale, ku nxënësit shqiptarë janë të obliguar që të mësojnë gjuhën maqedone ndërsa nxënësit maqedonas të mësojnë gjuhën shqipe.

Megjithatë sistemi arsimor nuk kërkon në mënyrë të detyrueshme që nxënësit maqedonas të mësojnë gjuhën shqipe, gjë e cila, sipas tyre zvogëlon bazat e një shoqërie multietnike. Segregimi i sistemit arsimor në RMV është mbështetur për shumë vjet në mënyrë të hapur, në mënyrë që të shmangeshin situatat konfliktuale ndërmjet nxënësve të grupeve të ndryshme etnike. Rezultati i kësaj ndarjeje solli në një thellim të diferencave midis komuniteteve të mbyllura në zonat e tyre. Pas 19 viteve nga arritja e Marrëveshjes së Ohrit, duhet pranuar fakti që sistemi arsimor ka dështuar në zhvillimin e një kohezioni social ndërmjet grupeve të ndryshme kulturore.¹⁰⁶ Sidoqoftë, diversiteti kulturor është i inkorporuar në rregullativat themelore kushtetuese, dhe mbrojtja e tij është inkurajuar dhe nga proceset e integritimit në BE dhe në NATO.¹⁰⁷

¹⁰¹Atanasoska, Tatjana (2017): German as a Foreign Language at Schools in Scotland, Sweden and Macedonia - a "small" subject?. European education al research association, Berlin. Në: <https://eera-ecer.de/ecer-programmes/conference/22/contribution/41358/>. Online më 15.11.2020.

¹⁰²Po aty.

¹⁰³OECD (2018): TALIS. Në: <http://www.oecd.org/education/talis/>. 15.04.2019.

¹⁰⁴Shih Programi i BE-Eurydice. Në: https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/former-yugoslav-republic-macedonia_en. Online më 18.11.2020.

¹⁰⁵Shih Programi i BE-Eurydice. Në: https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/former-yugoslav-republic-macedonia_en. Online më 05.12.2020.

¹⁰⁶Shih Bakiu, Bashkim/Dimitrova, Marija/Brava, Admir (2016): How to achieve integrated education in the Republic of Macedonia?. Skopje. Fq. 5.

¹⁰⁷Po aty. Fq. 7.

Kushtetuta dhe ligjet garantojnë dhe mbrojnë të drejtat e grupeve etnike për arsimim. Duke filluar nga klasa e gjashtë, nxënësve u kërkohet të mësojnë dhe dy gjuhë të tjera të huaja, të cilat gjithashtu janë të detyrueshme. Nxënësit duhet të zgjedhin mes gjuhës gjermane dhe asaj frënge. Të gjitha këto gjuhë, nxënësit i mësojnë derisa ata mbarojnë edukimin e ciklit të dytë. Gjatë njëzet viteve të fundit ka pasur një interes në rritje për të mësuar gjuhën gjermane, megjithëse duke iu referuar statistikave të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pas anglishtes, gjuha e dytë më e përdorur është frëngjishtja.

Në të njëjtën kohë, sistemi arsimor një rëndësi të madhe u ka dhënë lëndëve të tilla si matematika dhe gjuhët (gjuhës maqedone, shqipe, turke dhe serbe). Këto lëndë marrin dhe pjesën më të madhe të trajnimeve të organizuara në mënyrë zyrtare dhe që ndiqen nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit.¹⁰⁸ Gjatë këtyre trajnimeve, mësuesit marrin njohuri dhe eksperiencë që u mundësojnë atyre të kuptojnë më mirë mënyrën si fëmijët mësojnë matematikën, mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë, dhe në bazë të tyre të përdorin teknika dhe metoda inovatore duke punuar me nxënësit. Trajnimi i mësuesve të gjuhësisë zgjat 8 ditë ose 50 orë dhe temat për të cilat ato trajnohen janë:

- *Mësimdhënia cilësore e letërsisë;*
- *Konceptet, hapat dhe teknikat fillestare për të lexuarit;*
- *Konceptet në tekstet e printuara;*
- *Ndërgjegjësimi fonologjik, fjalori, rrjedhshmëria;*
- *Lidhja ndërmjet të lexuarit dhe të shkruarit;*
- *Konceptet, hapat dhe teknikat fillestare për shkrimin;*
- *Llojet e teksteve;*
- *Gramatika dhe rregullat gramatikore si dhe konventat;*
- *Vlerësimi formativ i të lexuarit dhe të shkruarit.*¹⁰⁹

Ashtu siç shikohet dhe më sipër, asnjë prej këtyre trajnimeve të mësuesve nuk përfshin tema të komunikimit ndërkulturor, pavarësisht se Maqedonia e Veriut është një shtet multi-etnik. Andaj duhet të merret modeli zviceran si modeli i politikave më të mira për mësimin e gjuhëve të huaja ose kombëtare. Kundërshtohet sidomos fakti i fillimit të anglishtes si gjuhë e huaj që në klasë të parë, ndërkohë modeli zviceran e fillon në klasë të tretë. Sidoqoftë, për shumë arsye ky proces nuk mund të ndalojë. Ndërkohë që *gjuha e dytë kombëtare në Zvicër fillon nga klasa e tretë*,¹¹⁰ kurse në RMV fillon në klasën e katërt, por gjuha shqipe duhet të mësohet dhe nga nxënësit maqedonas.

¹⁰⁸ Shih UNESCO(2015): The former Yugoslav Republic of Macedonia – Education for All 2015 National Review. Në: <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002317/231750e.pdf>. Online më 10.11.2020. Fq. 2.

¹⁰⁹ Po aty. Fq. 2.

¹¹⁰ Akademie des Wissenschaften Schweiz (2015): Schulischer Fremdsprachenunterricht in der Schweiz – Argumente zur Debatte. Vol. 10. Nr. 1. ISSN 2297-1599. Fq. 2-3.

2. Gjermanishtja para dhe pas viteve '90

2.1. Gjermanishtja para viteve '90

Politikat e brendshme dhe ato të jashtme janë ndër faktorët që ndikojnë më shumë në mësimin e gjuhëve të huaja dhe në përzgjedhjen e tyre në sistemin arsimor. Vendimet në lidhje me gjuhët zyrtare dhe cilat janë gjuhët që duhen mësuar në shkollë merren në nivel politik.¹¹¹ Kjo ishte pak a shumë ajo që ndodhte brenda kufijve të ish-Jugosllavisë. Për shkak të aleancës së ngushtë me Bashkimin Sovjetik, pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1948, rusishtja kishte ndikim të madh në të gjitha sferat e jetës, duke përfshirë dhe arsimimin.

Ajo mbështetej shumë nga qeveria e asaj kohe dhe mbizotëronte në shkollat e gjuhëve të huaja, megjithëse nuk ishte e imponuar, por kjo përzgjedhje ndikohej nga mbështetja e qeverisë. Për shkak të lidhjes së saj me „armikun“, fillimisht gjuha gjermane u ndalua nëpër shkolla, ndërkohë që anglishtja dhe frëngjishtja thjesht u „toleruan“. Në këto rrethana, nxënësit dhe studentët kuptuan rëndësinë e rusishtes për arsimimin e tyre dhe për karrierën e ardhshme. Kishte shumë grante të qeverisë për arsimimin dhe avancimin profesional në universitetet ruse dhe shkollat e tyre teknike.

Por duhet theksuar se *gjermanishtja si gjuhë e huaj në ish-Jugosllavi shfaqet rreth 70 vjet më parë në shkollat e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërsa vlen të përmendet si moment historik themelimi i Departamentin të Gjuhës Gjermane dhe Letërsisë në Fakultetin Filologjik në Shkup në vitin 1949*.¹¹² Shumë shpejt pas kësaj filloi mësimdhënia dhe nxënia e gjuhës gjermane në disa gjimnaze dhe shkolla të mesme profesionale. Kjo ndodhi menjëherë pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe kur Jugosllavia u tërhoq nga Blloku Lindor në vitin 1948. Ndërkohë Jugosllavia filloi rrugën e saj e vetme për ndërtimin e socializmit, në mes të viteve 1950-të, filloi dhe hapja e saj ndaj botës.

Në kundërshtim me vendet e tjera të bllokut lindor, qytetarët e saj mund të udhëtonin të lirë në vendet perëndimore pa pasur nevojë për viza, por nga ana tjetër politika pa viza e Jugosllavisë ndaj turistëve perëndimorë tërhoqi një numër të madh turistësh. Kështu filluan të ndryshonin dhe nevojat e vendit për mësimin e gjuhëve të huaja. Gjermanishtja u riprezantua nëpër shkolla në vitin 1948, gjë e cila përkon dhe me hapjen e departamentit të gjuhës dhe letërsisë gjermane në Shkup gjatë vitit 1949, por sipas politikave të kësaj kohe numri i nxënësve ndahej në mënyrë të barabartë ndërmjet katër gjuhëve: rusisht, gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht.¹¹³

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kjo gjë filloi të ofrohej edhe në shkollat fillore krahas anglishtes, frëngjishtes dhe rusishtes gjatë vitit 1960. Pavarësisht interesit të vogël në shkolla edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjermanishtja u bë shumë e rëndësishme dhe e përhapur në rajon për shkak të arsyeve praktike. Shkëmbimet me vendet gjermanishtfolëse ishin të shpeshta dhe ndërsektoriale: turistët që vizitonin bregdetin e Adriatikut në verë kryesisht vinin nga Gjermania Perëndimore, Austria dhe nga Zvicra. Si rezultat, shumë individë kishin përvoja të drejtpërdrejta me gjermanishten dhe kishin një nevojë urgjente për ta mësuar atë.¹¹⁴

¹¹¹ Shih Imamovic, Adisa/Delibegovic-Dzanic, Nihada (2016): The Status of English in Bosnia and Hercegovina: Past and Present. Publisher: Multilingual Matters. Editors: Louisa Buckingham. Fq.19-35.

¹¹² Avdic, Emina (2018): Frühes Deutschlernen in der Republik Mazedonien. Në: Petrovic, Ana/GolubSenjug, Ana/Gehrmann, Siegfried (Hrsg.) (2018): Deutsch von Anfang an. Frühes Deutschlernen als Chance. Münster-New York. F. 119.

¹¹³ Shih Imamovic, Adisa/Delibegovic-Dzanic, Nihada (2016): The Status of English in Bosnia and Hercegovina: Past and Present. Publisher: Multilingual Matters. Editors: Louisa Buckingham. Fq.19-35.

¹¹⁴ Po aty.

Në shkollat fillore, nxënësit mësonin vetëm një gjuhë të huaj: anglisht, gjermanisht, rusisht apo frëngjisht, duke filluar nga klasa e pestë, edhe pse mbetet ende e paqartë nëse ata e zgjidhnin vetë apo caktoheshin nga autoritetet në shkollë. Megjithëse ka disa burime që pohojnë se nxënësit mund të zgjidhnin një gjuhë dhe shumica prej tyre vendosnin për anglishten,¹¹⁵ autorë të tjerë e mohojnë këtë gjë duke thënë që autoritetet shkollore përcaktonin një numër të barabartë nxënësish për të mësuar rusisht, gjermanisht, anglisht ose frëngjisht.

2.2. Gjermanishtja pas viteve '90

Pas pavarësisë së Republikës së Maqedonisë në vitin 1991 u ndërmorën reforma të gjera në fusha të ndryshme të sistemit arsimor. Në veçanti pas Marrëveshjes së Ohrit dhe gjatë dhjetë vjetëve të fundit janë miratuar shumë dokumente arsimore politike, të cilat duhej të përmirësojnë rregullat, cilësinë dhe kualitetin në sistemin e përgjithshëm parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë.¹¹⁶ Së pari, gjuha e huaj u fut si gjuhë e dytë e huaj në shkollat fillore nga klasa e pestë në fillimin e viteve 1990, që ndikoi pozitivisht mësimdhënien dhe nxënien e gjuhës frënge dhe gjermane. Prej vitit shkollor 2008/2009 është obligative që nxënësit të mësojnë dy gjuhë të huaja në shkolla fillore, gjimnaze dhe ndonjë shkollë të lartë, ndër të cilat gjuha gjermane etablohet si gjuhë më e preferuar.

Ndërkohë gjatë viteve të 90-ta mësimi didaktik i gjermanishtes fitoi një përqsasje gjithmonë e më shumë ndërkombëtare dhe ndërkulturore, duke e lënë veten që të ndikohej nga shkencat humane dhe koncepti i kompetencës ndërkulturore. Gjatë kësaj kohe, kërkimet studimore në Gjermani vijuan të jenë të gjalla dhe të shumta duke sjellë propozime që do të donin t'i adoptonin dhe gjuhët e tjera.¹¹⁷ Dy studiuesit të cilët shënuan një fazë të re në didaktikën ndërkulturore të gjuhës gjermane ishin Eike Thürmann dhe Lothar Bredella. Eike Thürmann-i bashkëpunoi gjatë vitit 1992 për implementimin dhe realizimin e programit „Lernen für Europa“, një projekt „Landesinstitut für Schule und Weiterbildung“ që eksperimentoi në përgatitjen e të rinjve evropianë për një të ardhme multikulturore.¹¹⁸

3. Mësimi i gjermanishtes në RMV

Mësimi i gjermanishtes në Republikën e Maqedonisë së Veriut vazhdon të mbetet një qëllim i rëndësishëm për shkak se pjesa më e madhe e diasporës gjatë dekadës së fundit është zhvendosur në Gjermani. Emigracioni i viteve 1970-1980 ishte më shumë i përhapur në SHBA dhe në Australi, por ky emigracion është ulur në mënyrë të vazhdueshme, duke arritur shifra minimale përgjatë viteve të fundit.¹¹⁹

¹¹⁵ Shih Bancroft W., Jane (1974): Foreign Language Teaching in Yugoslavia, Wiley Online Library, fq. 104

¹¹⁶ Shih Национална програма за развој на образованието во Република Македонија 2005-2015(2005). Скопје: Министерство за образование и наука на Република Македонија. Në: <http://fvm.ukim.edu.mk/documents/Nacioanlna-programa-za-razvoj-na-obrazovaniето-v0-Republika-Makedonija-2005-2015.pdf>. Onlien më 10.10.2020.

¹¹⁷ Shih Snaidero, Tiberio (2008): L'Insegnamento della cultura nella didattica delle lingue straniere in Germania. Iicei Herwegh e Schiller. Berlino: studi di glottodidattica. 1. Fq. 120-132.

¹¹⁸ Po aty. Fq.126.

¹¹⁹ Shih Atanasoska, Tatjana (2017): German as a ForeignLanguage at Schools in Scotland, Swedenand Macedonia – a “small” subject? *European Educational Research Association. Berlin*. Në: <https://wera-ecer.de/ecer-programmes/conference/22/contribution/41358/>. Online më 15.09.2020.

Po ashtu, pas trazirave ndëretnike të viteve 1999-2001, është identifikuar se komunikimi ndëretnik është çelësi i ndërtimit të stabilitetit social në Republikën e Maqedonisë së Veriut.¹²⁰ Kjo edhe për shkak se grupet etnike kryesore – shqiptarët, maqedonasit, serbët dhe turqit - kishin njohuri të pakta të gjuhëve përkatëse. Studimet kanë treguar se mësimi i një gjuhe të huaj hedh bazat për (a) një ndryshim thelbësor në politikat gjuhësore arsimore të vendit dhe (b) një përmirësim të dallueshëm në metodologjinë e mësimdhënies së gramatikës në të gjithë Maqedoninë e Veriut.¹²¹ Trajnime të ndryshme për mësuesit e gjuhëve të huaja janë kryer sidomos në qytetet si Shkupi, Tetova dhe Kumanova.

Kështu nga gushti deri në dhjetor të vitit 2011 janë trajnuar për mësimdhënien e gramatikës dhe librit udhëzues rreth 444 mësues të gjuhës të 37 shkollave primare dhe 17 sekondare. Nga ky trajnim përfituan kryesisht mësuesit e gjuhës maqedonase dhe shqipe, por edhe mësuesit e gjuhëve të tjera kryesore si anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht. Trajnimet zhvillohen dhe për të marrë njohuri edhe mbi zhvillimin e kurrikulës të gjuhës si dhe për të zhvilluar aftësitë për detyrat gramatikore dhe për t'i dhënë ato në mësim.¹²²

Historikisht, në të gjithë rajonin e Ballkanit ka pasur një interes për mësimin e gjuhës gjermane, por sipas „Deutsche Welle-s“ ky interes ka qenë në rritje gjatë kohëve të fundit, dhe gjuha gjermane në Ballkan nuk është vlerësuar më shumë sesa sot. Përveç Maqedonisë së Veriut, interes në rritje për gjuhën gjermane ka pasur në Bosnje – Hercegovinë, Shqipëri, Serbi dhe Turqi. Në Maqedoninë e Veriut, gjuha gjermane mësohet edhe në shkollat publike dhe në ato private. „Goethe Institut“ luan një rol shumë të rëndësishëm për mësimin e gjuhës gjermane dhe sipas shifrave të saj numri i individëve që flasin gjermanisht në Maqedoni është rreth 63500, në Bosnje Hercegovinë është rreth 307 000, në Serbi 140 000 dhe në Greqi 268 530.¹²³

4. Përfundime

Në përgjithësi, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sigurimi i të dhënave dhe informacioneve në lidhje me mësimdhënien e gjuhës gjermane është problematik sepse në të shumtën e rasteve këto të dhëna mungojnë. Ka shumë pak dokumente që flasin në mënyrë të drejtpërdrejtë për mësimdhënien e gjuhës gjermane. Megjithatë, duke iu referuar të dhënave zyrtare vendore dhe organizatave ndërkombëtare për arsimin dhe zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, u tregua që Republika e Maqedonisë së Veriut po ndërmerr një sërë reformash arsimore për mësimin e gjuhëve të huaja si në arsimin fillor ashtu dhe në arsimin e mesëm.

Në të gjithë rajonin ka pasur një interes për mësimin e gjuhës gjermane dhe sipas të dhënave të përmendura ky interes ka qenë në rritje gjatë kohëve të fundit. Gjuha gjermane asnjëherë nuk është vlerësuar më shumë sesa sot. Përveç Maqedonisë së Veriut, interes në rritje për gjuhën gjermane ka pasur në Bosnje dhe Hercegovinë, Shqipëri, Serbi dhe Turqi. Në Maqedoninë e Veriut, gjuha gjermane mësohet edhe në shkollat publike dhe në ato private.

¹²⁰ Shih CAROLE-Centre for applied research and outreach in language education. (2012): Language learning and teaching in Macedonia –. University of Greenwich, Në: <https://www.gre.ac.uk/ach/services/carole/home/impact-projects/language-learning-and-teaching-in-macedonia-policy-and-delivery-2010-2012>. Online më 15.09.2020.

¹²¹ Po aty.

¹²² Po aty.

¹²³ Shih DW (2016): Learning German is gaining popularity in the Balkan states. Në: <http://www.dw.com/en/learning-german-is-gaining-popularity-in-the-balkan-states/a-35984926>. Online më 15.09.2020.

Referencat

- [1]. Akademie des Wissenschaften Schweiz (2015): Schulischer Fremdsprachenunterricht in der Schweiz - Argumente zur Debatte. Vol. 10, Nr. 1. ISSN 2297-1599.
- [2]. Atanasoska, Tatjana (2017): German as a Foreign Language at Schools in Scotland, Sweden and Macedonia – a “small” subject?. *European education al research association*. Berlin.
- [3]. Avdic, Emina (2018): Frühes Deutschlernen in der Republik Mazedonien. Nē: Petrovic, Ana/Golub Senjug, Ana/Gehrmann, Siegfried (Hrsg.) (2018): Deutsch von Anfang an. Frühes Deutschlernen als Chance. Münster-New York.
- [4]. Bakiu, Bashkim/Dimitrova, Marija/Brava, Admir (2016): How to achieve integrated education in the Republic of Macedonia?. Skopje.
- [5]. Bancroft W., Jane (1974): Foreign Language Teaching in Yugoslavia, Wiley Online Library.
- [6]. CAROLE-Centre for applied research and outreach in language education. (2012): Language learning and teaching in Macedonia –. University of Greenwich.
- [7]. DW (2016): Learning German is gaining popularity in the Balkan states.
- [8]. Imamovic, Adisa/Delibegovic-Dzanic, Nihada (2016): The Status of English in Bosnia and Hercegovina: Past and Present. Publisher: Multilingual Matters. Editors: Louisa Buckingham.
- [9]. OECD (2018): TALIS.
- [10]. Programi i BE-Eurydice.
- [11]. Snaidero, Tiberio (2008): l’Insegnamento della cultura nella didattica delle lingue straniere in Germania. licei Herwegh e Schiller. Berlin.
- [12]. UNESCO(2015): The former Yugoslav Republic of Macedonia – Education for All 2015 National Review.

Referencë me shkronja cirilike

- [1]. Национална програма за развој на образованието во Република Македонија 2005-2015. Скопје.